

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik “C.C.S” sh.p.k, NIPT J61901033C, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Sulejman Delvina”, Nr.8, kodi postar Nr.1019, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur me mjete elektronike - mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR.REF- 00117-04-04-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 (tridhjetë) ditë.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.18, datë 08/04/2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, NIPT J61817047D, me ofertë ekonomike 7,497,000 (Shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH;
- 2- Bashkimi operatorëve ekonomik “Rikon – AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, NIPT M31904013D (10%), me ofertë ekonomike 11,250,000 (Njëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH;
- 3- Operatori Ekonomik “C.C.S” sh.p.k, NIPT J61901033C, me ofertë ekonomike 13,787,000 (Trembëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1- Bashkimi operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, NIPT M31904013D (10%) pasi:

🚩 Formulari i ofertës i paraqitur nga bashkimi operatorëve ekonomik “Rikon – AL” sh.p.k, NIPT L22119010H (90%) & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, është në kundërshtim me

dokumentat e tenderit. Është paraqitur formular oferte sipas DST shërbime si dhe Lista e çmimeve të shërbimeve ndërkohë që procedura është procedurë mallrash.

✚ Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 8 (tetë) copë printera MFP A4/A3 Color 30ppm + Set Toneri. Nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, janë ofertuar 5 (pesë) copë printera. Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.

✚ Në kërkesën e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që ofertuesi duhet të paraqesë 5 (pesë) copë printera MFP A4/A3B&W 30ppm + Set Toneri. Nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rikon - AL” sh.p.k & “QuantX IT Solutions” sh.p.k, janë ofertuar 8 (tetë) copë printera. Oferta ekonomike është plotësuar në kundërshtim me specifikimet teknike.

2- Operatori Ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, NIPT J61817047D, pasi ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët.

Në zbatim të nenit 93 pika 5 të ligjit Nr.162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet se:

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “C.C.S” sh.p.k, NIPT J61901033C, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Sulejman Delvina”, Nr.8, kodi postar Nr.1019, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13,787,000 (Trembëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erlind Sulo